



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:090074  
Datë: 13.02.2025  
Numri i dokumentit: 06845347

P.nr. 74/24

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË** -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren Juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarve H.H.dhe F.H.për shkak të veprës penale Shpërdorim i pasurisë së huaj në bashkëkryerje nga neni 318 par.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së PTH-Gjakovë me numër PP.nr.625/23 të dt. 18.03.2024., pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.31.01.2025, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, i akuzuari H.H.ti, i akuzuari F.H., me dt. 03.02.2025 shpallë, ndërsa me dt.13.02.2025, e përpilon këtë:

**A K T G J Y K I M**

**TË AKUZUARIT:**

1. I akuzuari **H.H.** nga i ati R. dhe e ëma X. e lindjes B., i lindur me dt. ... nga fsh. C. k.Malishevës ku edhe banon, me nr.personal ..., shqiptar, shtetas i R të Kosovës, i martuar, i ati i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në sektorin privat, i gjendjes së dobët ekonomike.

2. I akuzuari **F.H.** nga i ati F. dhe e ëma H. e lindjes G., i lindur me dt. ..., në fsh. C. komuna e Malishevës ku edhe banon, me nr.personal ...., shqiptar, shtetas i R të Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike.

**J A N Ë F A J T O R Ë**

Për shkak se me datë 26.04.2023 rreth orës 11:15 minuta në Rr. „I.M.“ në Malishevë, në bashkëveprim me njëri tjetrin dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, e përvetësojnë pasurinë e personit tjetër të cilën e kanë gjetur, dhe atë të dëmtuarit H.S, në atë mënyrë që ditën kritike të pandehurit derisa kanë qenë me veturën e tipit “...” duke lëvizur nëpër qytet, i vërejnë të hollat në tokë dhe menjëherë i pandehuri F. e ndal veturën dhe i thotë të pandehurit H. „zbrit nga vetura dhe merri të hollat” ashtu që pasi i marrin të hollat shkojnë në kafiterinë „M.”, i numërojnë dhe rezultojnë të jenë 1500 euro të cilat i kishin rënë të dëmtuarit nga xhepi, ku më pas të pandehurit i ndajnë në pjesë të barabarta nga 750 euro dhe shkojnë në Prishtinë i shpenzojnë, me ç’rast të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm material në vlerë prej 1500 Euro.

- Me këto veprime kanë kryer veprën penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj në bashkëkryerje nga neni 318 par.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69 dhe nenin 318 par.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovë të njëjtit i:

## G J Y K O N

**1. Të akuzuarin H.H.me** dënim me gjobë në shumën prej **pesëqind euro (500€)**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhironlogarinë e kësaj gjykate 30 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në të kundërtën nëse dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e cekur, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej dhjetë (25) ditësh, duke llogarit çdo njëzet (20) euro në një (1) ditë burgu, - si dhe

- me dhe **dënimin me kusht** në kohëzgjatje prej **3 (tre)** muajve burgim, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor pre 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

**2. Të akuzuarin F.H.,** me dënim me gjobë në shumën prej **pesëqind euro (500€)**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhironlogarinë e kësaj gjykate 30 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në të kundërtën nëse dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e cekur, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej dhjetë (25) ditësh, duke llogarit çdo njëzet (20) euro në një (1) ditë burgu, si dhe

- **Me dënimin me kusht** në kohëzgjatje prej **3 (tre)** muajve burgim, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor pre 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

**URDHËROHET** Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gj. që t'i mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë dënimin me kusht, ashtu që **OBLIGOHEN** të akuzuarit që të mbajnë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gj..

Obligohen të akuzuarit në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën secili nga njëzet (20) euro, për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit, shumën secili nga njëzet (20) euro, ndërsa shpenzime te procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, në të kundërtën ekzekutimi do te behet me detyrim.

I dëmtuari H.S nga fsh. M. K. Malishevë, lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën numër PP.nr.625/23 e dt. 18.03.2024, e ka akuzuar H.H.dhe F.H.për shkak të veprës penale Shpërdorim i pasurisë së huaj në bashkëkryerje nga neni 318 par.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarit t'i shpallë fajtorë dhe t'i dënojë në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 31.01.2025, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, prezent kanë qenë i akuzuari H.H., dhe F.H., ndërsa në mungesë të të dëmtuarit H.S për të cilin shërbimi i postës ka konstatuar se i njëjti gjendet jashtë shtetit, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari H.H., në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se me vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, për të cilin jam penduar, po ashtu kërkoj falje, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin, po ashti i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do te bije ndesh me ligjin, andaj kërkoj nga gjykata që të me shqiptoj një dënim sa më të butë.

I akuzuari F.H.është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, për të cilin jam penduar, po ashtu kërkoj falje, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin, po ashti i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do te bije ndesh me ligjin, andaj kërkoj nga gjykata që të me shqiptoj një dënim sa më të butë, pasi që jam mbajtës i familjes dhe atë në sekretin privat.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj ka deklaruar: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarve dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse të akuzuarit pranimin e fajësisë e bënë me vullnet të plot, pa presion dhe pa shtytje nga askush, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe të akuzuarit të shpallën fajtor, të dënohen sipas ligjit si dhe të obligohen në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

### 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se të akuzuarit i kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

- se të akuzuarit H.H.dhe F.H. me dashje kan kryer veprën penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj në bashkëkryerje nga neni 318 par.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykim.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Raporti i policit F.T., dt.28.04.2023;
- Deklarata e të dëmtuarit H.S, e dhënë në Stacionin Policor në Malishevë me dt.27.04.2023;
- Deklarata e të pandehurit H.H.ti, e dhënë ne Stacionin Policorë në Malishevë me dt.28.04.2023;
- Deklarata e të pandehurit F.H., e dhënë ne Stacionin Policorë në Malishevë me dt.28.04.2023;
- CD -Video incizimi i datës 26.04.2023;
- Fotografitë dhe shkresat tjera në lëndë.

### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 318 par.5 është paraparë se „ *Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme përvetëson pasurinë e luajtshme të personit tjetër, të cilën ai e ka gjetur ose tek posedimi i së cilës ka arritur rastësisht, me qëllim që vetes ose personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.*

### 5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarit H.H.dhe F.H.i ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohen, nga se në veprimet e tyre të përshkruara si në dispozitivin e aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj në bashkëkryerje nga neni 318 par.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. për këtë ka vendosur që të akuzuarit t'i shpall fajtor dhe t'i gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ka vlerësuar që të akuzuarve duhet t'u shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat

e kryesve si dhe përgjegjësinë penale të tyre, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata me rastin e caktimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajit nga ana e të akuzuarve të njëjtit janë penduar, dhe kanë shfaqur keqardhje për veprimet e tyre, premtimin e tyre se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla, për herë të parë kanë ra ndesh me ligjin, janë të gjendjes së dobët ekonomike dhe mbajtës të vetëm të familjes, andaj gjykata të akuzuarve H. dhe F.H.iu shqiptoj dënimin me gjobë në shumë secili nga pesëqind (500) euro, të cilën shumë janë të obliguar që ta paguajnë në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe dënimin me kusht për secilin, në kohëzgjatje prej tre (3) muajve burgim, të i cili dënim nuk do te ekzekutohet në afatin kohor prej një (1) viti, nëse të akuzuarit nuk kryejnë vepra tjera penale, gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7. Vendimi për udhëzimin në kontestin civil

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil gjykata e mori konform nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

#### 8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.74/24, me dt. 03.02.2025**

Sekretarja juridike  
**Behije Karaçica**

Gjyqtari i vetëm gjykues  
**Lulzim Paçarizi**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.